



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 35

Datë: 22. 04. 2021. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Ibrahim Selmanaj, kryesues i mbledhjes së KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Kurteshi, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Ibrahim Selmanaj, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së Nr.34/2021.

2. Aktivitetet e SKQZ-së:

3. Aktivitetet e ZRPP-së:

4. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore;**

-Shqyrtimi dhe miratimi i specifikimeve teknike për shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave për zgjedhjet lokale 2021;

- Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë së informimit publik për zgjedhjet lokale 2021.
- Shqyrtimi dhe miratimi e konkursit për kompozimin e “Melodisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

5. Të ndryshme

1.Hyrje: z. Ibrahim Selmanaj, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së Nr.34/2021.

Në mungesë të kryetares, mbledhja u kryesua nga Ibrahim Selmanaj, anëtarë i KQZ-së.

Ibrahim Selmanaj: Përhëndetje. I kemi pesë pika të mbledhjes, a ka ndokush ndonjë propozim tjetër...?

Burim Ahmetaj: Është një pikë që nuk e kemi trajtuar në KOZ...duhet për u trajtuar në mbledhjen e radhës së KOZ-it në mënyrë që të vijë pastaj në KQZ...

Alim Rama: Pika “Shqyrtimi dhe miratimi i specifikimeve teknike për shtypjen e fletëvotimeve dhe broshurave për zgjedhjet lokale 2021”, është kthyer për trajtim kështu që, dhe tani nuk është e gatshme për trajtim...

Ibrahim Selmanaj: Pra, hiqet nga rendi i ditës...

Në vazhdim të mbledhjes, anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së nr.34/2021.

2. Aktivitetet e SKQZ-së:

Burim Ahmetaj: Sekretariati është në procesin e fundit të draftimit të raportit të punës së KQZ-së, dhe se shqyrtimi në Sekretariat do të bëhet, dhe ne në javën e ardhshme do ta sjellim në KQZ. Jemi brenda afatit...

Jemi në proces të asgjësimit të materialit zgjedhor, në proces të procedurave të tjetërsimit të pasurisë që, disa do të jepen donacion, dhe pastaj uvsprei do të asgjësohet...

Po punojmë rreth fillimit të hapave të parë për përgatitjen lidhur me zgjedhjet e rregullta lokale, dhe jemi duke e përgatitur një dokument për strukturën e stafit jo permanent që do të angazohet në zgjedhje...Pra, një komision ka filluar punën në këtë drejtim...

Sami Kurteshi, pyeti se cilat aspekte teknike – organizative – administrative janë në plan të cilat, nuk shkojnë deri në ditën e zgjedhjeve por që përgatiten përpara...?

Burim Ahmetaj: Në mbledhje sot e kemi një pikë të informimit publik që, menjëherë mbas miratimit, ne mund ti fillojmë procedurat... Pra, ne do t'i përfshijmë të gjitha aktivitetet e informimit publik sipas afateve... Po ashtu, edhe disa aktivitete paraprake që lidhen me fletëvotimet dhe shtypjen e tyre mund ti zhvillojmë qysh tani... Kemi edhe aspekte të tjera, dhe për shkak të kohës së bollshme ne po i ndajmë tenderimit brenda muajve, në mënyrë që gjithçka të zhvillohet brenda ligjit dhe afateve kohore procedurale...

Alim Rama, pyeti rreth çështjes së shkatërrimit të uvsprejtit, në fakt nëse MMPH ka kthyer përgjigje rreth kësaj çështje...!

Burim Ahmetaj: Nuk kemi ende diçka konkrete, nuk kemi raport të komisionit por, në momentin e parë do t'ju informojmë...

3. Aktivitetet e ZRPP-së:

Yll Buleshkaj: Kam përgatitur raport, ashtu siç është kërkuar me shkrim. Pikat kyçe janë: po vazhdojmë punën rreth ngritjes së kapaciteteve të zyrës-pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare; jemi duke e shqyrtuar aplikacionin politik të një iniciative politike për regjistrim; sipas kërkesës së kuvendit kemi përgatitur një raport financiar për partitë politike; rreth fondit për financimin e partive politike etj.

Sami Hamiti: E kam lexue raportit...Më intereson çështja e auditimit...! Kjo pasqyrë, a vlen edhe për periudhat e mëhershme - raportet e tjera, apo veç për ato të pa audituara...?

Yll Buleshkaj: Vlenë vetëm për raportet e pa audituara... Raporti është kërkuar për shpallje të tenderit, pra janë kërkuar informacione...

Arianit Elshani, u interesua rreth konferencës ndërkombëtare dhe çështjet që lidhen me kërkesën e kuvendit...

Yll Buleshkaj: Po, do të ju informojmë dhe mbase, edhe do tua dërgojmë raportin përmbledhës të konferencës dhe çështjet tjera për të cilat u interesuat...

Eshref Vishi: Më vjen mirë që ju e keni bërë kontrollin e strukturës së raportimit financiarë që është e bazuar në ligj nga subjektet politike, ndërsa të gjeturat ose mos përputhjet eventuale të deklarimeve financiare janë pjesë e auditimit... Mirë është që ju e kontrolloni gjendjen financiare...

Alim Rama, tha se pavarësisht, raportet financiare të partive të publikohen...

4. Raporti i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Operacione Zgjedhore;

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë së informimit publik për zgjedhjet lokale 2021:

Alim Rama: KOZ-i, ka miratuar strategjinë e Informimit Publik për zgjedhjet lokale 2021. Strategjia, është para jush...

Z. Rama, paraqiti në përgjithësi një përmbledhje të shkurtër mbi qëllimin, objektivin, buxhetin e strategjisë, produktet etj.

Eshref Vishi, tha se strategjia është analoge, megjithatë tek përmbajtje trendët nga zgjedhjet e kaluara mund t'ishin bazë ashtu si edhe mësimet e nxëna për të shkuar më tej, por nuk mendoj se duhet të jenë pjesë e strategjisë së zgjedhjeve lokale 2021... Nuk po e shoh se janë "konkluzionet e dala nga mësimet e nxëna", nëse janë marrë parasysh brenda strategjisë është në rregull. .. Por trendët, vetëm sa e rëndojnë strategjinë dhe nuk hyjnë në punë në vitin 2021...

Artan Asllani: Në zgjedhjet qendrore, ku unë isha kryesues i këshillit mbikëqyrës të IP-së kishim problem me prokurimin në aspektin kohorë por, tash ka mjaftueshëm kohë...

Sami Hamiti: Trendet, na kanë dhënë pasqyrë të mirë, ashtu si edhe reflektimi i mësimet të nxëna...Mirëpo, konsideroj se është një dokument i mirë... Ka analogji, por fushëveprimi është i njëjtë...Me kohë është përgatitur, aprovuar dhe konsideroj se është një strategji e mirë...

Në këtë pikë, diskutuan më tej: Alim Rama, Sami Hamiti, Arianit Elshani, i cili propozoi që të bëhet edhe monitorimi i mediave në raport me sponsozimin e partive politike, të spoteve të tyre në mënyrë që të rritet transparenca. KPM duhet të mbikëqyrë respektimin e ligjit, pra të shohim a ka përputhje me deklaratimet financiare të raporteve të partive, pra të shohim a kemi informacione të sakta...

Në fund, strategjia miratohet me vota unanime...

2. Shqyrtimi dhe miratimi e konkursit për kompozimin e “Melodisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”:

ALim Rama: Si pjesë të strategjisë s informimit publik, ne e kemi diskutuar që KQZ duhet ta ketë një tingull të vetin, origjinal si një lloj himni...Kjo, i shërben KQZ –së për të gjitha zgjedhjet...

Është përgatitur konkursi, janë ndarë edhe 3 çmime...për melodinë sepse, tekst nuk ka...! Materialin e keni, ne rekomandojmë për aprovim...

Sami Kurteshi, pati vërejtje rreth çmimit, mirëpo Sami Hamiti tha se, çmimi është akademik, pastaj diskutoi edhe Arianit Elshani, Artan Asllani, Ibrahim Selmanaj dhe Eshref Vishi, i cili pyeti nëse ka kësi praktikash...

Alim Rama, tha se melodia është unike në pronësi e KQZ-së, dhe se këso praktikash ka...

Në fund, anëtarët e KQZ-së e miratuan me vota unanime rekomandimin e KOZ-it mbi publikimin e Konkursit për kompozimin e “Melodisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.